



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Krimi kompjuterik (2017/2018)**

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Kodi	N-SPEC-CC
Titulli	Specialist në lëminë e krimit kompjuterik
Numri në arkiv i akreditimit [60]	03-612/3
Vendimi për fillim me punë	03-1619/18 (10.11.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

Përshkrimi i programit

Fusha e drejtësisë penale sot po ndryshon. Të arriturat më të reja teknologjike, bashkë me ndodhitë botërore bashkëkohore, krijuan nevojën për rritjen e numrit të profesionistëve për drejtësinë penale të cilët kanë njohuri nga fushat sociologjike, juridike, teorike, teknologjike dhe praktike për zbatimin e ligjit në botën e sajberit.

Ky program profesional do të mundësojë shkallë më të lartë të specializimit në të dyja fushat, drejtësi dhe IT dhe si i tillë është i paraparë për ata të cilët kanë dëshirë të përparojnë në fushën e të drejtës penale me komponent të rëndësishëm të TIK në të, ose thjeshtë të përfitojnë njohuri më të thella për këtë disiplinë fascinante në punën profesionale.

Kandidatët në këtë nivel të studimeve do të ndjekin kurse ku do t'i analizojnë sjelljet kriminale të sajber ekosistemit, do t'i aplikojnë njohuritë e tyre në ekspertime, do t'i mësojnë teorinë e kontrollit social, dhe do të përfitojnë perspektivë të informatave për zbatimin e ligjit, sistemit gjyqësor si dhe në përgjithësi për atë se çfarë do të thotë teknologjia.

Studentët të cilët do të mbarojnë këtë nivel të studimeve do të jenë në gjendje që të demostrojnë:

- Njohuri dhe aftësi të avancuara për ta vlerësuar teorinë e drejtësisë penale e kriminologjike dhe implikimet e tyre në politikën e praktikën publike në kuadër të botës së sajber ekosistemit.
- Shkathtësi në forenzikën digjitale, analiza hulumtuese lidhur me evaluimin e arsyeve të kriminalitetit të shkaktuara nga sajber bota në tërësi.
- Kompetencë të mjaftueshme që t'i vlerësojnë dhe t'i zgjidhin çështjet etike në praktikën e drejtësisë politikës dhe hulumtimit penal.
- Shkathtësi që t'i sintetizojnë, t'i vlerësojnë, t'i njohin implikimet dhe të komunikojnë në mënyrë efektive duke shfrytëzuar burime shkencore të informacioneve lidhur me teorinë dhe politikën e kriminalitetit si dhe kriminalitetin kompjuterik.
- Kuptimin e teorive dhe aftësive për leadership, si sillen ato me menaxhimin dhe udhëheqjen e organizatave për drejtësi penale.
- Të jenë të gatshëm si kuadër për tregun e punës me performanca të larta me gërshetimin e më të mirës nga teoria dhe praktika e së drejtës penale me njohuritë dhe praktikën nga teknologjia.

Karriera

- Natyra e aplikuar e këtij programi do t'ju ndihmojë të përgatiteni për një rol në sektorin publik apo privat, potencialisht duke hetuar hakerime, tregjet online të drogës, rrjetin e errët, shfrytëzimin seksual në internet, mbrojtjen e fëmijëve në internet e më shumë më tepër.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të avancuara teorike, empirike dhe komparative për shkencat juridike-penale si dhe njohuri të avancuara për legjislacionin dhe praktikën gjyqësore në fushën e parandalimit të kriminalitetit.
- I kupton në mënyrë të thellësishme problemet lidhur me Kriminalitetin dhe sanksionet penale veçantërisht në fushën e të drejtës penale krahasimtare dhe të drejtës së procedurës penale, kriminologjisë dhe penologjisë, Kriminalitetinologji dhe penologji teorike dhe të zbatuar, kriminalitetit të organizuar dhe shkenca forenzike (mjekësi ligjore, psikiatri dhe psikologji).
- Ka njohuri specifike për teknikat e avancuara dhe metodat e hulumtimit në fushën e të drejtës penale dhe procedurës penale.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Identifikon dhe analizon probleme komplekse në fushën e të drejtës penale dhe procedurës penale, ashtu që mund të luajë rol aktiv në të gjitha stadet e procedurës penale, ndërkaq mundet edhe të interpretojë çështje të avancuara nga legjislacioni penal (përfshirë punën si gjykatës, prokuror publik apo avokat, pasi që t'i fitojë kualifikimet e nevojshme sipas legjislacionit të RM)
- I zbaton njohuritë e fituara përmes hulumtimit në procesin e zgjidhjes së problemeve përmes krahasimit të praktikave dhe zgjidhjeve në fushën e parandalimit të kriminalitetit.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ka mendim kritik më të avancuar përmes metodave për analizë dhe zbatim.
- Zhvillon shkathtësi për zgjidhjen e problemeve përmes praktikës së zgjidhjes së rasteve komplekse nga praktika gjyqësore dhe jurisprudenca vendore dhe ndërkombëtare.

Aftësitë e komunikimit

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në fushën e shkencave juridike-penale.
- Sjell vendime të avancuara dhe punon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efikase në procedurë hetimore dhe gjyqësore.
- Përfshihet në mënyrë aktive në argumentime dhe debate shkencore.
- I përdor gjuhët zyrtare të Universitetit dhe ka shkathtësi të avancuara në teknologjitë informatike në punën profesionale.

Aftësitë e të mësuarit

- Zhvillon rregullore për punë hulumtuese e cila përdoret në profesionin e tij/saj.
- Zhvillon praktikë të mësimit të vazhduar duke u angazhuar për trajnimin e personave të cilët punojnë në institucionet shtetërore për parandalimin e kriminalitetit.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [SCC-0101] [6.0 SETK] **Kriminaliteti kompjuterik**
- [SCC-0102] [6.0 SETK] **Hulumtimi aplikativ digjital forenzik**
- [SCC-0103] [6.0 SETK] **E drejta në TI**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [SCC-0201] [6.0 SETK] **Menaxhimi me drejtësinë penale**
- [SCC-0202] [6.0 SETK] **Siguria e zbatuar e rrjetit dhe të dhënave**
- [SCC-0203] [6.0 SETK] **Punë praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Kriminaliteti kompjuterik**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i informojë studentët me aspektet juridike të kriminalitetit kompjuterik. Përdorimi i teknologjive informatike është karakteristikë kryesore e kohës së sotme. Jeta e njeriut bashkëkohor nuk mund të imagjinohet pa arritjet teknologjike të cilat janë pjesë e çdo segmenti jetësor. Nga ana tjetër, zhvillimi i këtillë i shpejtë teknologjik ka edhe anën e tij të errët, e cila përfshin përdorimin e tij për qëllime kriminale. Në aspektin bashkëkohor, kriminaliteti kompjuterik është forma më e përhapur e kriminalitetit duke marrë parasysh numrin e madh të shfrytëzuesve të mjeteve teknologjike i cili korrespondon me numrin e lartë të viktimave nga këto vepra. Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë format e paraqitjes së kriminalitetit kompjuterik, mënyrën e rregullimit ligjor të këtij fenomeni si dhe karakteristikat kryesore fenomenologjike, tipologjike dhe etiologjike të kësaj forme të kriminalitetit.

- **Hulumtimi aplikativ digjital forenzik**

Kjo lëndë ka për qëllim që t'u sigurojë studentëve njohuri dhe kuptim për të dhënat të ndryshme digjitale të cilat mund të shfrytëzohen për hetimin e kriminalitetit digjital dhe jo-digjital, si dhe për proceset dhe mjetet të cilat përdoren për realizimin e hetimit forenzik kompjuterik. Studentët do t'u nënshtrohen rasteve të ndryshme, përmes të cilave ata do të mësojnë që t'i identifikojnë detyrat që duhet të kryhen dhe të zgjidhin qasje dhe mjete adekuate që duhet të shfrytëzohen. Studentët, gjithashtu, do të analizojnë artefakte dhe detaje të ndryshme të cilat mund të ju kenë ikur gjatë fazës hetimore. Studentët, gjithashtu, do të mësojnë si t'i ndjekin proceset sistematike gjatë kryerjes së hetimit digjital si dhe ta përforcojnë aftësinë e tyre për nxjerrjen e përfundimeve në bazë të rezultateve të tyre.

- **E drejta në TI**

Qëllimet e lëndës: - të njohohen me nocionet themelore, konceptet dhe karakteristikat kryesore në fushat të cilat e përfshijnë të drejtën e teknologjisë informative si dhe disiplinën shkencore juridike aplikative. - të diskutojnë dhe të debatojnë në tema nga fusha e interesave të ndërthurura të drejtësisë dhe teknologjive informatike. - të zhvillojnë aftësi për kërkimin e informatave në hapësirën sajber, relevante për profesionin juridik. - t'i zbatojnë normat themelore ligjore në rastet konkrete nga praktika, t'i përforcojnë kapacitetet analitike dhe aftësinë për mendim kritik.

- **Menaxhimi me drejtësinë penale**

Qëllimet e programit mësimor: Konteksti i personave të cilët menaxhojnë me drejtësinë penale është mjaft i tensionuar. Kjo lëndë i identifikon strukturat themelore dhe organizimin e institucioneve të drejtësisë penale dhe i kushton vëmendje mënyrës në të cilën ato udhëhiqen dhe menaxhohen. Kjo lëndë do t'i qartësojë konceptet kyçe të menaxhimit me drejtësinë penale si dhe idetë të cilat janë kornizë për kuptimin e kompleksitetit të menaxhimit me institucionet juridike-penale.

- **Siguria e zbatuar e rrjetit dhe të dhënave**

Kjo lëndë është dizajnuar që t'i mësojë studentët se si në mënyrë të drejtë të sigurojnë një ueb server, ueb faqe apo ueb aplikacion. Studentët do t'i marrin ueb aplikacionet ekzistuese dhe do t'i ridizajnojnë që të jenë sa më të sigurta. Studentët, gjithashtu, do të dizajnojnë dhe do të ndërtojnë faqe e-commerce duke përdorur praktikën më të mira për siguri. Studentët do të mësojnë edhe si t'i mbrojnë informatat konfidenciale (financiare dhe të dhënat personale). Si pjesë e sigurisë është edhe testimi i sigurisë dhe dobësitë e ueb aplikacionit. Për këtë qëllim, studentët do t'i mësojnë teknikat ekzistuese për pushtimin e ueb aplikacioneve dhe ueb servereve. E gjithë kjo studentëve do t'u sjellë disa teknika për testim të drejtë të ueb aplikacioneve të tyre në karrierat e tyre akademike dhe profesionale.

- **Punë praktike**

Qëllimi i punës praktike është t'u ofrojë studentëve mundësinë të fitojnë përvojë nga kjo lëndë. Puna praktike do të zhvillohet me mbështetje nga: Katedra për shkencë dhe shkathësi ushtarake, Njësia për luftë kundër krimit kompjuterik, Prokuroria publike në RM, Departamenti për krim kompjuterik në Ministrinë e punëve të brendshme në RM etj.

Lëndë zgjedhore

- **Siguria e ueb-aplikacioneve**

Kjo lëndë është dizajnuar që t'i mësojë studentët se si në mënyrë të drejtë të sigurojnë një ueb server, ueb faqe apo

ueb aplikacion. Studentët do t'i marrin ueb aplikacionet ekzistuese dhe do ti ridizajnojnë që të jenë sa më të sigurta. Studentët, gjithashtu, do të dizajnojnë dhe do të ndërtojnë faqe e-commerce duke përdorur praktikat më të mira për siguri. Studentët do të mësojnë edhe si t'i mbrojnë informatat konfidenciale (financiare dhe të dhënat personale). Si pjesë e sigurisë është edhe testimi i sigurisë dhe dobësitë e ueb aplikacionit. Për këtë qëllim, studentët do t'i mësojnë teknikat ekzistuese për pushtimin e ueb aplikacioneve dhe ueb servereve. E gjithë kjo studentëve do t'u sjellë disa teknika për testim të drejtë të ueb aplikacioneve të tyre në karrierat e tyre akademike dhe profesionale.

- **Hakerimi etik**

Kjo lëndë ka për qëllim që të krijojë "haker etik" i cili në realitet është profesionist i kualifikuar i cili di dhe kupton se si të shikohen dobësitë dhe lëshimet në sistemin e kompletuar dhe t'i shfrytëzojë njohuritë dhe mjetet e njëjta si një hacker keqdashës, por në mënyrë ligjore dhe legjitime, që ta vlerësojë sigurinë e tërë sistemit. Kjo lëndë është dizajnuar me qëllim që t'u mundësojë njohuri dhe aftësi gjatë udhëheqjes së luftës kundër sajber kriminelëve dhe që t'i mbani të sigurta mjetet e fituara. Lënda do të përfshijë temat më të rëndësishme të arkitekturës dhe sistemeve kompjuterike, programimit të sistemeve operative dhe bazave të të dhënave, bashkë me temat e specializuara nga shkenca digjitale krimnologjike, çështjet juridike, rrjetizimi, hackerimi etik dhe siguria kompjuterike. Përvoja është dizajnuar që të jetë praktike, kërkohet që të njoftoheni me mjete për testim dhe depërtim në sisteme, algoritme për enkriptim të softuerit për analizë forenzike, bashkë me pjesën e studimeve tradicionale në klasë.

- **Politikat dhe procedurat e sigurisë së TI**

Qëllimi i kësaj lënde është t'u mundësojë studentëve që t'i zbatojnë politikat dhe procedurat e sigurisë për përkrahje të qëllimeve organizative. I diskuton metodologjitë për identifikim, kuantifikim, zbutje dhe kontroll të rreziqeve të sigurisë. Studentët mësojnë të shkruajnë plane për menaxhim me rrezik të sigurisë në përputhje me standardet dhe udhëzimet më të mira të sigurisë dhe praktikat dhe teknikat më të mira për rikuperimin e infrastrukturës së IT-së, sistemeve, rrjeteve, të dhënave dhe qasjes së përdoruesit.

- **Kriminologjia**

Qëllimet e lëndës: - Fitimi i njohurive rreth lëndës studimore të kriminologjisë, institutet kryesore krimnologjike, kuptimi dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në kryerjen e veprave penale, hulumtimet krimnologjike lidhur me kryerësin dhe viktimën e veprës penale. - Identifikimi dhe analizimi i problemeve krimnologjike. - Analizimi kritik të koncepteve dhe termeve karakteristike për hulumtimet krimnologjike. - Përdorim të suksesshëm të terminologjisë së mësuar nga fusha e krimnologjisë në debate të ndryshme dhe argumentime në këtë drejtim. - Zhvillimi i sistemit të mësimiit përmes identifikimit dhe përdorimit të burimeve kryesore të kriminologjisë.

- **Viktimologjia**

Qëllimet e lëndës: - Fitimi i njohurive për nocionin, themelimin dhe zhvillimin e viktimologjisë si shkencë e veçantë juridike-penale, kuptimi i pozitës së viktimës së veprës penale si subjekt i veçantë, nevojat e saj dhe mënyrat e kompenzimit si dhe përfshirja e saj në procedurë penale. - Identifikimi dhe analizimi i problemeve kryesore viktimologjike me të cilat ballafaqohet kjo shkencë bashkëkohore. - Analiza kritike e koncepteve dhe termeve viktimologjike, si dhe përdorimi i njohurive të fituara për zgjidhjen e rasteve hipotetike lidhur me viktimat e veprave penale. - Përdorimi i suksesshëm i terminologjisë së mësuar nga fusha e viktimologjisë në debate të ndryshme dhe argumentime nga kjo fushë. - Zhvillimi i sistemit të mësimiit përmes identifikimit dhe përdorimit të burimeve kryesore të shkencës së viktimologjisë.

- **Kriminaliteti i organizuar**

Qëllimet e lëndës: Fitimi i njohurive themelore për veprat penale nga fusha e kriminalitetit të organizuar, për format e manifestimit të tyre, mënyrat e paraqitjes dhe mënyrat e menaxhimit me të njëjtat. Përmes këtij programi studentët do të jenë të aftë që përmes procesit të integritetit të tyre në rrjedhat shoqërore të ndihmojnë në përkufizimin e formave të kriminalitetit klasik dhe formave të kriminalitetit të organizuar. Gjithashtu do të aftësohen për gjetjen dhe ndërmarrjen e mjeteve dhe metodave më adekuate për ndriçimin e këtij lloji të veprave penale si dhe atë se cilat njohuri do të implementohen në punën operative – praktike me zbulim të suksesshëm të veprave penale nga fusha e kriminalitetit të organizuar.